



|  |            |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO |            |
| KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRAN   |            |
| 01 Nr. / Br                            | 61/21      |
| Nr. i fq. / Br. st                     | -13-       |
| Data: / Datum                          | 25.03.2021 |
| VUSHTRRI - VUÇITRAN                    |            |



REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -II- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 25 SHKURT 2021**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:15.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Ismet Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Syla, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova dhe Teuta Aruçi Shartari.

**Munguan:** Ymer Haradinaj dhe Fitim Halili.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe i autorizuari i kryetarit të komunës z.Afrim Namani, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 33 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Bahrije Ademi-Murati, anëtare e kuvendit**-në adresimin e saj para kuvendit, për njoftim të qytetarëve të Vushtrrisë, si shefe e grupit kuvendar të Lëvizjes VETEVENDOSJE, duke e ndjere obligim moral për sqarim para secilit, po iu drejtohem me pak fjalë për të përgjithësuar gjerat që ndodhen muajin e fundit. Në seancën e kaluar u miratua padrejtësisht një nga pikat shumë të rëndësishme për qytetin tone "Strategjia për Rimëkëmbje Ekonomike". Ne si grup i LVV në kuvendin komunal të Vushtrrisë, nuk e kundërshtuam, ashtu siç u paraqit për publikun nga ana e kryetarit. Kur e patëm miratuar këtë Strategji ne parim, jemi dakorduar që bashke me planin ideor të sillen projektet konkrete për implementim. Ndërkaq, erdhi vetëm si projekt ideor, gjë që ishte e papranueshme pre ne si Lëvizje që ta lejojme keqperdorimin e parasë publike, duke miratuar një shumë prej 140.000 eurosh vetëm për plan ideor. Ishte mjaft e pakuptimtë dhe fëmijërore, se si kryetari këmbëngulte që po nuk kaloi sot nuk do ta sjell me pre votim këtë pike të rendit të ditës. Në të njëjtën kohë kjo linte vend për shume dyshime, kujt i konvenoi ta kalonte me kaq nguti, shkel e shko, një plan strategjik shumë i rëndësishëm për qytetin tonë, të cilit iu bashkëngjiti edhe opozita e PDK. Kjo përveçse e çuditshme, edhe e dyshimte. Se çka po fshihet prapa kësaj, e ardhmja do ta tregoj?! Qytetar të dashur, ne si Lëvizje VETEVENDOSJE! do të jemi gjithmonë pranë jush të përgjegjshëm e ballëhapur, sepse ne jemi parimor dhe të drejte, e pikërisht çështja e

drejtësisë dhe e parimeve e shtyu koalicionin drejte prishjes nga ana e kryetarit Tahiri. Sepse, këtij kryetari i pengon llogaridhënia e transparenca. Prandaj, nga këtu, po ju drejtohem, për të ju treguar që zgjedhjet lokale nuk janë larg, sepse ashtu siç u bë ndryshimi rrënjësor në Podujeve e në mbarë Kosovën, ashtu do bëhet edhe në Vushtrri.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-** në adresimin e tij para kuvendit, potencoi dy çështje për t'i paraqitur në këtë seancë, qytetarët shtrojnë shumë pyetje në lidhje me të parën. Pse qëndrojnë posterët dhe billboardat edhe pas përfundimit të zgjedhjeve, në komunën tonë, ka poster edhe në afërsi të objektit të komunës. Nuk dua të paragjykoj, por po ta pyesnim Ushtruesen e Detyrës së Presidentes z.Vjosa Osmani, se a duhet të qëndroi posterit i saj në murin e ndërtesës që nga zgjedhjet e “6 tetorit” aty, goxha i sigurt jam se do të thoshte largojeni. Do të thoshte largojeni sepse në zgjedhjet e fundit ka garuar me sloganin “Guxo”, ndërsa në poster e ka sloganin “Beso”, pastaj në zgjedhjet e kaluara ka garuar me numër një në listën e LDK-së, kurse në këto zgjedhje ka garuar me numër dy në listën e VV-së. Konsideroj se nuk po i bëni nder që po e mbani atë poster, dhe bëj thirrje që të largohet edhe ai poster edhe të gjithë të tjerët rrugëve të qytetit tonë. Sugjeroj që në një nga seancat e radhës të përfshihet për shqyrtim dhe aprovim Propozim-Vendimi për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Propozimi im është që ky institucion të quhet QKMF Dr. “Safet Idrizi” Vushtrri. Kjo nismë vije pas shumë konsultimeve me qytetarë dhe punonjës të QKMF-së, dhe arsyetimin e bazojmë në kontributin e jashtëzakonshëm të të ndjerit Safet Idrizi, në veprimtarinë e tij, para, gjatë dhe pas luftës. Konsideroj se ne kemi obligim të përkujdesemi për të gjithë dhe veçmas të respektojmë kujtimin dhe kontributin e atyre kur nuk janë në mesin tonë. *Në vazhdim ai prezantoi një përmbledhje të biografisë të Dr. Safet Idrizit:*

Dr. Safet Idrizi lindi në fshatin Beçiq me datën 07.01.1957. Shkollën fillore e kreu në Duboc të Vushtrrisë, ndërsa të mesmen e vazhdoi në gjimnazin në Vushtrri. Studimet Bachelor i kreu në Fakultetin e Mjekësisë, pas përfundimit të së cilave vazhdoi me specializimin në Mjekësinë Familjare, ndërsa studimet Master i përfundoi në drejtimin e Menaxhimit. Si student në atë kohë, ai morri pjesë në demonstratat e vitit 1981 dhe për 37 vite shërbeu si mjek humanist. Në vitet e 90'ta Safet Idrizi u shërbeu nxënësve të helmuar në atë kohë nga regjimi serb. Gjatë gjithë këtyre viteve ai ishte në shërbim të popullit, para luftës, gjatë luftës si doktor dhe pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishte sfidë e madhe të ishte bir i një fshatari në malësinë e varfër të Drenicës. Dr. Safeti kaloi shtigjeve të panjohura të dijes me vendosmërinë e tij, bukë misri dhe librin në duar. Filloi të flitej për dhjetat e studentit të shkëlqyeshëm të Mjekësisë, përkushtimi dhe edukata e të cilit u bënë shembull jo vetëm në fshatin ku jetoi, por edhe më gjerë. Pikërisht atyre shtigjeve Dr. Safeti marshoi me stetoskop, gërsërë e pushkë ushtari të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në rrugën e lirisë dhe porosive të Komandant Legjendar Adem Jasharit. Dr. Safeti nuk ndjente lodhje ditë as natë, kurdo ishte i gatshëm në ndihmë të të sëmurëve në luftë e në liri. Së fundi, më luftën kundër Kuçedrës së padukshme, virusit korona, mori krah dragoi për mundjen e saj. Ai la gruan dhe 4 fëmijët e tij, që të gjithë studentë në drejtime të ndryshme të Mjekësisë. Ai, Doktorit fitues i luftës, i paqes, tani ra dëshmor në Luftën me virusin e padukshëm për të mos vdekur kujtimi i tij. Me 31.10.2020 ndërroi jetë, me ç' rast u dekorua me medalje presidenciale të meritave nga Republika e Kosovës me titull “Post mortem” për përkushtimin human ndaj pacientëve dhe sakrificën sublime në betejën me pandeminë Covid-19. Pas vdekjes së tij, Dr. Safet Idrizit iu dha dekoratë edhe nga kryetari i Odës së Mjekëve të Kosovës me titull “Nderi i Mjekut Ali Sokoli – për kontributin e veçantë të dhënë në luftën me pandeminë Covid-19”. Të gjithë qytetarët që e njohën, familjarët dhe miqtë do ta kujtojnë Dr. Safet Idrizin përherë si një humanist të shquar, të pandalshëm, të urtë dhe punëtor të jashtëzakonshëm.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-ngriti shqetësimin lidhur me mos emërimin e drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë, kur dihet nevoja dhe urgjenca që ekziston për shkak të përpalljes me pandemie covid-19, apeloj që të gjithë drejtoritë e mbetura vakant të plotësohen me drejtor të ri, pas kjo çështje është mjaft me urgjencë. Në këtë mbledhje si rezultat i mungesë së drejtorëve, mungojnë shumë pika të rendit të ditës siç është statutit i QKMF-së, pastaj statuti i Qendrës për Punë Sociale, ku drejtori në këtë qendër është vendosur në mënyrë të kundërligjshme. Ndërsa propozimin për emërimin e QKMF-së me emrin e Dr.Safet Idrizit e mbështesin unanimitisht si grup kuvendar i LVV-së.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së**-duke ju referuar diskutimit të znj. Bahrije Ademi, vlerësoi se pak kanë rëndësi interpretimet, kur dihen faktet reale se grupi kuvendar i LVV-së në mbledhjen e kaluar nuk e kishte aprovuar Planin për Rimëkëmbje Ekonomike.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se kryetari i komunën në prononcimin para mediave, lidhur me Planin për Rimëkëmbje Ekonomike, kishte thënë shumë të pavërteta, për faktin se grupi i LVV-së kishte kërkuar që ai plan të shtyhet për aprovim për një mbledhje të më vonshme, ndërsa ai ka deklaruar se grupi kuvendar i LVV-së e ka kundërshtuar aprovimin e Planit për Rimëkëmbje Ekonomike.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-përsërit se në mbledhjen e kaluar kishte propozuar që Plani për Rimëkëmbje Ekonomike, të shtyhet për një mbledhje tjetër, pasi që ai të analizohet mirë, pa u ngutur, ashtu që të kemi një plan praktik dhe që do të konsistonte me rrethanat e Vushtrrisë. Ai apelo që mos të merren vendime të ngutshme por vendime racionale dhe në interes të qytetarëve.

**Bahrije Ademi-Murati, anëtare e kuvendit**-lidhur me planin përsërit se është shumë e rëndësishme, përmbajtja e tij, pasi që si grup politikë i LVV-së ka kërkuar që të ketë projekte konkrete të gatshme për implementim e jo projekte ideore siç edhe janë aprovuar.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-deklaroi se e habit fakti i qëndrimeve të anëtarëve të LVV-së, pasi ata si duket janë penduar për atë se si kanë votuar në mbledhjen e kaluar lidhur me Planin për Rimëkëmbje Ekonomike. Ai përsërit se në mbledhjen e kaluar kishte kërkuar që mos të votohet ai plan sepse është vetëm për fushatë elektorale. Ndërsa dikujt po i duket se këtë propozim e ka bërë një parti e vogël por mos harron se rrethanat ndryshoj duke e parafrazuar Ndre Mjeden: *<Bilbil kjo botë orë e çast ndërrohet të mëdhenjtë bien e të voglit qohen>*.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-tha se për gjithçka që është folur e vendosur në mbledhjet e kuvendit, ekzistojnë procesverbalet dhe kjo është mirë, andaj edhe në mbledhjen e kaluar dihet fare mirë qëndrimi i grupit kuvendar të LVV-së lidhur me planin për rimëkëmbje ekonomike, dhe kundërshtimi i atij plani ka qenë parimor për faktin se nuk kemi dashur të lejojmë të shpenzojmë 140,000.00 € për disa projekte ideore dhe kjo në opinion është keqinterpretuar nga ana e kryetarit të komunës por që është demantuar nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje në Vushtrri.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së**-tha se arsyeimi i LVV-së se nuk e kanë kundërshtuar plani për rimëkëmbje ekonomike, nuk qëndron për faktin se ata kanë votuar kundër në mbledhjen e kaluar lidhur me këtë dokument. Sa i përket transparencës për këtë plan velën të theksohet dhe duhet kujtuar se për të janë zhvilluar shumë diskutime dhe janë mbajtur edhe punëtori në Republikën e Shqipërisë dhe në atë kohë nuk ka pasur vërejtje dhe kundërshtime. Për bërë krejtësisht transparente procedurën e aprovimit të këtij plani, zyra kombëtare e auditimit ndoshta do ta ketë mostër këtë plan dhe atëherë do të shohim se a është gjithçka në rregull sa i përket këtij plani. Lidhur me iniciimin e procedurës për këtë plan, kërkesa është bërë nga drejtori që ka qenë nga radhët e LVV-së, ndërsa çmimin dhe koston e këtij projekti e përcakton ligji i konkurrencës.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit**-tha se vetë koalicioni i lidhur mes LVV-së e LDK-së, nuk ka qenë për të ashtuquajturën kthim të shpresë qytetare, por është bërë për interesa të ngushta

personale mes këtyre dy subjekteve politike. Kjo është dëshmuar që nga filltet e para të veprimit politike, ku grupi i LVV-së, nuk i kishte thënë asnjë fjalë të vetme kur ishte shkarkuar drejtori Sedat Rashica, sepse atëherë zyrtaret e LVV-së kanë pasur punë tjera për të përfituar për veten e tyre. Koalicioni ishte jo parimor dhe kishte synim ta largonte PDK-në nga pushteti, por qytetari e ka parë se kush janë në të vërtet këta që qeverisën për këto tri vite. Zyrtaret e LVV-së, i kanë punësuar grat e tyre dhe ju kanë dhënë edhe subvencione të ndryshme. Nëse Lëvizja Vetëvendosje dëshiron të silltet si opozitë, ajo duhet të kërkoj shkarkimin e kryesuesit të kuvendit.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-tha se po shihet koketimi politik i Xhafer Tahirit dhe PDK-së, në Vushtrri, kjo po shihet ashiqare nga prononcimet e tyre. Ajo vlerësoi se nuk ka nevojë të emërohen drejtor nga askush, sepse anëtarët e LVV-së veprojnë mbi bazën e parimeve, dhe atëherë kur këto parime u thyen ndodhi edhe prishja e koalicionit.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se për tri vite anëtarët e LVV-së kanë votuar për ato çështje që kanë qenë në interes të qytetarëve, ndërsa bashkëpunimi i nëntokës mes z.Xhafer Tahirit dhe PDK-së ka qenë bukur i hershëm.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit**-tha se nëse folmi për disa anëtar dhe anëtare të LVV-së, që kanë qenë konsistente dhe kanë punuar për LVV-në, atëherë për ta gëzon njëfarë respekti e simpatie. Por kur flasin disa sikur puna e Hajriz Mustafes e Nasuf Aliut, për ta nuk ka se çfarë të flitet pasi ata janë oportunist politik, dhe këtë e ka dëshmuar më së miri Nasuf Aliu, i cili mund të shpallet servil i dekadës i cili për interesa personale i ka shfrytëzuar disa parti politike gjatë dhjetë viteve të fundit. Andaj këta nuk kanë pse të na flasin për parime, sepse të gjithë këta kalkulojnë për interesa të ulëta personale. Kur ka qenë në pyetje interesi qytetar Partia Demokratike e Kosovës gjithëherë ka qenë konstruktive dhe i ka votuar të gjitha vendimet për të mos i bllokuar interesat e qytetarëve. Partia Demokratike e ka ndryshuar dhe transformuar qytetin e Vushtrris duke investuar 110,000.000 €, ndërsa të tjerët nuk e kanë vendosur as edhe një gozhdë të vetme dhe tani na flasin, ai e kupton konsumimin politik por nuk mund të thuash nëntoka, sepse nëse ke fakte urdhëro dërgoj ato në institucionet e drejtësisë. Nëse dikush ka qenë që ka bërë opozitë ka qenë i vetmi që ka bërë opozitën edhe nga vet subjekti i tij politik, në debatet televizive ka qenë i vetmi që ka marr pjesë të tjerët nuk e kanë pasur guximin.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit**-duke polemizuar me anëtarin e kuvendit z.Lorik Maxhuni, ceku se ka pasur respekt për këtë të fundit për shkak edhe të konsideratës familjare, por edhe për faktin si një djalë i ri që ka besuar në potencialet për të ardhmen. Por tendenca për të goditur poshtë brezit është jo etike dhe e papranueshme.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-tha se ka respekt për Lorik Maxhunin si bashkëmoshatar, por e vërteta është se ai nuk duhet ti fyej bashkëpunëtorët e saj sepse Lëvizja Vetëvendosje është rritur aq shumë sa që tani po ka problem në kontrollin e prurjeve, por një ndër prurjet produktive është edhe z.Nasuf Aliu.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-tha se nuk po i pëlqen aspak diskursi politike i shpenzimet të energjisë i njëres parti kundër tjetres, kjo do të duhej të jetë ndryshe që kjo energji të shpenzohet në interes të qytetarëve. Pasi jemi në pluralizëm politik secili shkon aty ku e ndjenë dhe ka simpati politike. Ai potencoi se të gjitha partitë politike që operojnë në satabilishmentin politik mendon se punojnë në interes qytetar. Ai apeloj për bashkëpunim, për respekt e konsideratë mes partive politike dhe anëtarëve të kuvendit ashtu që të mundësohet shtyrja përpara e punëve në interes të përgjithshëm qytetar.

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit**-tha se është i kuptueshëm fakti i sulmit ndaj Lëvizjes Vetëvendosje, kjo për faktin se ajo tashmë është rritur shumë që ka marrë 20,000.00 vota në

Vushtrri, ndërsa LDK-ja është mbet e parëndësishme, ndërsa PDK-ja minorene. Andaj për tu faktorizuar, duhet sulmuar i fuqishmi.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-uroj kryetarin e komunës për lindjen e djalit, ndërsa falënderoj Dr.Hysni Gërgurin për kontributin dhe konstruktivitetin që ka treguar gjatë këtyre tri viteve të fundit.**

**Afrim Namani, drejtor i DA-së-falënderoj Dr. Hysni Gërgurin, për kontributin e dhënë, ndërsa kërkoj nga Lëvizja Vetëvendosje që vota që i ka marr ti mbaj dinitetshëm e jo të përdor ato për përçmim dhe tallje ndaj të tjerëve.**

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-lexoj pikat e rendit të ditës që janë dërguar në të ndryshme.**

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit-lidhur me propozim-vendimin për caktimin e lokacionit për sheshin e “Pavarësisë”, vlerësoi se për këtë parcelë ekziston një vendim i kuvendit që është dhënë në shfrytëzim për katër dhjetë (40) vite. Komisioni që është bërë për atë parcelë nuk ka zhvilluar asnjë procedurë sepse kryetari i komisionit nuk ka ftuar asnjë mbledhje. Rrjedhimisht për këtë çështje i bie që të merren dy vendimi dhe propozoi që këto kjo pikë dhe ajo që ka të bëjë me rrënimin e objektit të komunës të largohen nga rendi i ditës. Për çështje e kësaj parcele duhet të zhvillohen procedurat e dhënie në shfrytëzim dhe nëse nuk ka të interesuar atëherë le të ndërmerren procedura tjera.**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të PDK-së, kërkoj që të gjitha pikat e dërguara në të ndryshme të shtyhen për një mbledhje të ardhshme për faktin se asnjëra nga këto pika nuk ka ndonjë urgjencë. Lidhur me parcelën, ku ekziston ish-objekti i gjykatës, bëri të ditur se ekziston një vendim tjetër për dhënien e asaj prone në shfrytëzim, dhe saktësoj se për këtë çështje duhet të konsumohen procedurat ligjore.**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se gjithherë ka qenë ithtar që pika e ndryshme që ofrohen me vonesë në kuvend mos të procedohen, vetëm në rastet kur ato kanë ndonjë urgjencë. Në rastin konkret përgëzoj grupin kuvendar të LVV-së për qëndrimi që po mban sa i përket këtyre pikave në të ndryshme për qëndrim opozitar të cilin me herët nuk e mbajtur për shkak të jo konsistencës së tyre. Ftoj të ketë një opozitë të bashkuar.**

**Afrim Namani, drejtor i DA-së-tha se nëse është tendenca vetëm sa për ti kundërshtuar këto pika atëherë jemi në rregull, për këto pika –tema nuk janë personale janë punë të institucionit dhe për to duhet të degjohet mendimi i drejtorëve se a janë të natyrë urgjente apo jo.**

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-tha se nuk duhet të ngutemi me veprime, sepse ka tema që duhet trajtuar e që kanë urgjencën e tyre. Propozim për caktimin e lokacionit të ndërmarjes “Përparimi” i cili është vendosur me vota unanime në mbledhjen e kaluar është kthyer nga ministria e linjës që është kërkuar ndryshimi sa i përket referencës juridike, të thirrjes në Planin Zhvillimor Komunal. Pikë tjetër që konsideron me urgjencë është caktimi i një anëtar i komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës në zonë ekonomike në Lummadh, e cila duhet të votohet sot ashtu që mos të ketë ngecje sa i përket këtij projekti kapital për Komunën e Vushtrrisë. Lidhur me parcelën tek ish-gjykata komunale, sqaroi se kjo pronë nuk është në listën e pronave për dhënien në shfrytëzim, pasi kemi vlerësuar se nuk ka interes që kjo pronë të jepet në shfrytëzim.**

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit- në emër të grupit kuvendar të LVV-së, kërkoj pesë minuta pauzë për konsultim të grupeve kuvendare dhe shefave të tyre.**

*Pas konsultimit të shefave të grupeve kuvendare, Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit njoftoi se pika e dërguara në të ndryshme u vendos të votohen në mënyrë të veçantë d.m.th një nga një.*

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së**-sqaroi se komisioni i drejtorisë ka dalë në teren për të bërë vlerësimin e gjendje faktike të objektit të banesës së përbashkët e cila gjendet në rr. “Dëshmoret e Kombit, dhe me ç’ rast ka bërë edhe një paramasë dhe parallogari, ku shuma investive është mjaft e lartë që nuk kemi mundësi ti ndajmë, por që është menduar që nga një kontratë kornizë nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim të intervenohet në rregullimin e pullazit të atij objekti.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-njoftoi se lidhur me këtë fushë ekziston një ligj që e rregullon këtë materie, dhe pyeti se ai objektet a e ka të caktuar administratorin si obligon ligji. Intervenimi në rregullimin e këtij objekti, duhet pasur kujdes, pasi edhe nëse shkohet sipas kodit ekonomik në Drejtorin për Mbrojtje dhe Shpëtim nuk kemi të drejt të marrim mjetet sepse ato mjete shërbejnë për një fushë krejt tjetër.

*Lidhur me pikën e rendit të ditës: raporti i komisionit komunal për konstatimin e gjendje faktike të banesës së përbashkët e cila gjendet në rr. “Dëshmoret e Kombit” Nr. 92 në Vushtrri, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendos që kjo pikë të futet në rend të ditës.*

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se pas konsultimeve lidhur me Propozim – vendimin për shtyrjen e afatit të pagesë të këstit për lejet ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë, kuvendit me, u bindem se kjo çështje ka urgjencën e saj për shkak të rrjedhjes së afateve ligjore, andaj grupi kuvendar i PDK-së do ta përkrahë këtë pikë të rendit të ditës.

*Lidhur me pikën e rendit të ditës: Propozim – vendimi për shtyrjen e afatit të pagesë të këstit për lejet ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendos që kjo pikë të futet në rend të ditës.*

*Lidhur me pikën e rendit të ditës: Rishqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtrri, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendos që kjo pikë të futet në rend të ditës.*

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-lidhur me propozim-vendimi për rrënimin e ish-objektit të gjykatës komunale, tha se kjo pikë nuk duhet procedura në rend të ditës, pasi për këtë çështje ekziston një vendim i mëhershëm për dhënie në shfrytëzim, pastaj se bëhet fjalë për një sipërfaqe të vogël ku nuk do të mund të kemi rregullim të ndonjë sheshi të mirë.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së**-tha se procedimi i kësaj çështje në kuvend, ka ardhur nga kërkesa e kryetarit të komunës, dhe pas analizave të bëra nga komisionin komunal dhe një ekspertizë e jashtme nga një kompani profesionale ku janë marrë mostrat e materialeve beton, armatura dhe tjegullat. Urgjenca e kësaj çështje është se objekti është duke u dëmtuar dhe duhet marr shumë shpejt një vendim lidhur me këtë çështje.

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit**-tha se si grup kuvendar i LVV-së janë të mendimi që kjo pikë duhet të shtyhet pasi që për këtë çështje ekziston një vendim tjetër për dhënien e asaj prone në shfrytëzim.

*Lidhur me pikën e rendit të ditës: Propozim-vendimi për rrënimin e objektit të ish-gjykatës komunale, kuvendi pas votimit me 10 vota “për”, 16 vota “kundër” vendosi që kjo pikë të mos futet në rendit të ditës.*

*Lidhur me pikën e rendit të ditës: Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sheshit "Pavarësia" kuvendit pas votimit me 5 vota "për", 17 vota "kundër", 7 vota "abstenim" vendosi që kjo pikë të mos futet në rendit të ditës.*

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-kërroi që të prezantohet një profil i shkurtër lidhur me anëtarin e këtij komisioni që është prezantuar në propozim-vendim.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se është konflikt interesi nëse drejtori i Drejtorisë së Prokurimit bëhet pjesë e këtij komisioni, dhe propozoi që në këtë komision të votohet për pozitën që anëtarë të jetë drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, dhe kushdo që emërohet drejtor i kësaj drejtorie sipas detyrës zyrtare të jetë anëtar i këtij komisioni.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-propozoi që pjesë e këtij komisioni të jetë z.Haki Maloku.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së**-tha se Ligji për Zonat Ekonomike, nuk e parasheh që komisioni për këtë çështje të formohet nga ana e kuvendit, po kjo kompetencë bie në domenin e kompetencave të kryetarit të komunës. Me qëllim të rritjes së transparencës propozim për themelimin e këtij komisioni i është dërguar kuvendit. Ai njoftoi se komisioni aktualisht është funksional, por pas ka pasur pozitë vakante është proceduar propozimi për plotësimin e këtij komisioni.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit**-vlerësoi se komisioni aktualisht është funksional, dhe plotësimi i tij nuk është e domosdoshme të jetë nga qeveria komunale, në këtë rast mund të plotësohet edhe me ndonjë anëtar të kuvendit, dhe mund të jetë edhe nga radhët e LVV-së, pasi edhe më herët kjo pozitë i ka takuar këtij subjekti. Kërkoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhje e ardhshme që vjen një propozim tjetër konkret dhe të vazhdohet tutje.

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit**-pyeti se përse disa drejtori që janë besnik ndaj kryetarit të komunës bëhen pjesë e disa komisioneve.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së**-kërroi nga anëtarët e kuvendit që diskutimet ti bazojnë në argumente, e jo në paranoja dhe në konspiracion, kur të propozojnë diçka duhet të jenë konkret dhe racional. Ai prezantoi anëtarët e komisionit para kuvendit dhe shprehu kënaqësinë e tij që gjithë këta anëtarë janë besnik ndaj kryetarit të komunës.

*Lidhur me pikën e rendit të ditës: Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit, të kuvendit të komunës me numër të protokollit Nr.270/20 i datës 30.12.2020 për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave dhe për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industriale në Lummadh, kuvendit pas votimit me 11 vota "për", 15 vota "kundër" vendosi që kjo pikë të mos futet në rendit të ditës.*

**Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me vota "unanime" aprovoi këtë:**

## R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 28 janar 2021;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2020;
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lejimin e pagesës së mjeteve financiare për KEDS-in;
4. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020;
5. Shqyrtimi i raportit të komisionit komunal për konstatimin e gjendje faktike të banesës së përbashkët e cila gjendet në Rr. "Dëshmoret e Kombit" Nr. 92 në Vushtri.

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shtyrjen e afatit të pagesë të kështit për lejet ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë;
7. Rishqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtrri;
8. Të ndryshme;

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 28 janar 2021;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 28 janar 2021.*

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2020;

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-sqaroi** se Policia e Kosovës stacioni në Vushtrri, nuk kanë obligim që kuvendit ti ofrojnë raport, por kjo pikë duhet të kalojë vetëm si informatë dhe këtë e ka proceduar sipas rregullit Sekretaria e Kuvendit.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-tha se informata për gjendjen e sigurisë duhet të trajtohet gjithëherë si pikë e parë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lejimin e pagesës së mjeteve financiare për KEDS-in;

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit**-konstaton se pika e dytë e këtij propozim-vendimi, duhet të ndryshohet sa i përket kategorisë ku merren mjete financiare dhe atë nga kategoria komunalit në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lejohet pagesa e mjeteve financiare në vlerën njëzetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy euro e katër dhjetë cent (24,992.40 € ) për KEDS për marrjen e Pëlqimit për kyçjen në rrjetin elektroenergjetik të Parkut Industrial në Lumadh.

2. Shuma e mjeteve financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të realizohet nga kategoria Komunalit, nga Drejtoria për Shërbime Publike.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë ditë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020;



**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se kishte me qenë mirë që pyetjet që i parashtrijnë anëtarët e kuvendit, përgjigjet që vinë nga qeveria komunale tu dërgohen të gjithë anëtarëve të kuvendit për njoftim.

5. Shqyrtimi i raportit të komisionit komunal për konstatimin e gjendje faktike të banesës së përbashkët e cila gjendet në rr. "Dëshmoret e Kombit" Nr. 92 në Vushtrri;

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se konform kompetencave ligjore, komuna është e obliguar të iu dal në ndihmë dhe ti realizoj kërkesat e qytetarëve. Në rastin konkret kuvendi ka marrë vendim për aprovimin e peticionit të qytetarëve parashtruar kuvendit. Paramasa dhe paralogaria e hartuar nga ana e komisionit , është legjitime dhe e njëjta duhet të realizohet në praktik për tu dal në ndihmë këtyre qytetarëve. Në këtë kontekst ceku se kuvendi duhet ta aprovoj paramasen dhe paralogarin dhe të iniciohen në mënyrë të përshtetshme procedurat e prokurimit publik, ashtu që të mundësohet që sanohet gjendja e rënd që është në atë objekt. Në kuadër të këtij vendimi duhet të autorizohet qeveria komunale që ti ndërmer të gjitha veprimet e duhura për realizimin e kësaj shume financiare konform paramasës.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së**-tha se kjo çështje është diskutuar paraprakisht me zyrën ligjore dhe me Drejtorinë e Financave, dhe kemi mendimin se është e pamundur që aprovohet kjo paramasë sepse nuk e kemi një kod të veçantë ekonomik që do të mundësonte realizimin e kësaj shume të mjeteve financiare. Andaj vlerësoi se është e pamundur që të zbatohet një vendim i tillë i kuvendit, dhe mundësia e vetme është që shkohet përmes kontratës kornizë që është në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim që të intervenohet në rregullimin e pullazit të atij objekti.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se me vendim të kuvendit mund të autorizohet Drejtoria e Prokurimit që ti zhvilloj procedurat për ta mbuluar mjete për intervenim në këtë objekt. Ndërsa gjetja e mjeteve financiare mund të bëhet nga ndonjë kod ekonomik dhe kjo është çështje teknike e qeverisë komunale. Në rastin konkret kemi obligim për gjetjen e mjeteve për këtë projekt, pasi që kuvendi ka marr vendim për aprovimin e peticionit të atyre banorëve.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-sqaroi se lidhur me këtë çështje ekziston Ligji 04/L-134 për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi dhe përsërit se para se të merret një vendim është mirë të marrim mendimi profesional nga zyra ligjore lidhur me këtë çështje.

**Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit**-tha se sa ka para ajo në atë ndertës, ka rrezik potencial për banoret që janë duke banuar aty, dhe propozoi që urgjentisht të intervenohet në rregullimin e saj.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së**-sqaroi se komisioni i drejtorisë, e ka kryer punën e vetë në konstatimin e gjendje faktike të atij objekti, dhe rrjedhimisht ka hartuar paramasen dhe paralogarin, ku është nxjerr kostoja e rivitalizimit të atij objekti. Në konsultim me zyrtarin ligjor dhe atë financiar, është bërë e ditur se nuk mund të merret vendim i kuvendit për mbulimin e shumës financiare të përcaktuar në paralogari. Andaj në këtë kontekst përsërit se e vetmja alternativ është intervenimi përmes Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim sipas kontratës kornizë ku do të rregullohej pullazi i atij objekti.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-tha se është mirë që të gjendet një zgjidhje lidhur me këtë problematikë, por duke pasur gjithherë kujdes që mos të bëjmë shkelej ligjore. Ai vlerësoi se ky peticion është aprovuar, por tash e tutej do të kemi edhe peticione tjera që do të parashtrohen nga ana e qytetarëve dhe duhet pasur një rregull uniforme se si të veprohet.

**Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë ligjor**-fillimisht sqaroi se zyra ligjore e Komunës, nuk ka kompetencë të bëjë interpretim të ligjeve, këtë e bënë ministria gjegjëse, andaj të gjitha aktet e

aprovuara nga kuvendi i komunës i nënshtrohen shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, kur kemi dilema të tilla kuvendit mund ti adresohet për vlerësim kësaj ministrie. Sa i përket çështjes që është objekt shqyrtimi ligji në fjalë me emërtimin Ligji i Banesave në Bashkëpronësi, konkretisht neni 40, fletë për administrimin e rregullt, ku në vijimësi përcakton riparimet e nevojshme, ndër tjera riparimi i pullazeve, konkretisht ky ligj përcakton se komunat në bashkëpunim me shoqatat apo kryesit e banesave zgjedhin administratorin, përgjegjës financiar, dhe banoret me vetë participim kujdesën për riparimin e ndërtesë, pjesëve që janë në pronësi të përbashkët. Andaj konstatoj se ligji në fjalë as nuk e lejon e as nuk e ndalon mbështetjen financiare nga komuna, për intervenime të tilla në rregullimin apo riparimin e ndërtesave në bashkëpronësi. Nëse vendoset që të ndahen mjete financiare atëherë Drejtoria për Buxhet dhe Financa është e obliguar të gjej linje buxhetore ku do ti merr mjetet financiare.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-tha se zyra ligjore është e obliguar të jetë prezentë në mbledhjet e kuvendit, për faktin se duhet të jep rekomandime lidhur me aspektin ligjor në kuadër të kompetencave të kuvendit për marrë vendime. Kjo e ngrit kualitetin e punës së kuvend dhe mundëson respektimin e ligjit gjatë aktiviteti të kuvendit.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së**-sqaroi se për financimin e kësaj kërkesë, duhet të kemi kod buxhetor nga kategoria e investimeve kapitale, sepse kemi të bëjmë me investim kapital në rast e diskutuar nuk e kemi një kod të tillë dhe kështu një investim i tillë nuk mund të realizohet. Andaj forma e vetme është me participim nga ane qytetarëve me 50% dhe nga komuna nga fondi për bashkëfinancim.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se realizimi i këtij vendimi në këtë formë është i pamundur, sepse ata banor nuk i kanë mundësit të participojnë me masën prej 50 %. Andaj forma më e mirë prapë do të ishte rregullimi i pullazit të atij objekti nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

**Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 1 votë “kundër” të tjerët nuk morën pjesë në votim u vendos më sa vijon:**

**1. Me këtë vendim aprovohet kërkesa e parashtruar në emër të Suada Plakollit, për adoptimin e banesës së përbashkët e cila gjendet në rrugën “Dëshmorët e Kombit” Nr. 92 në Vushtrri.**

**2. I delegohen kompetencat dhe përgjegjësitë Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, që të ndërmarrë të gjitha veprimet në zhvillimin e procedurave për intervenim në rregullimin e pullazit të asaj ndërtesë.**

**3. Autorizohet qeveria komunale, që të ndërmarrë veprimet e nevojshme, duke përdorur mekanizmat ligjor të kontratave kornizë që i ka në dispozicion, për rinovimin e kësaj ndërtesë, duke sanuar gjendjen e rënd në këtë objekt.**

**4. Mjetet financiare për realizimin e këtij projektit, merren në kategorinë mallra dhe shërbime nga pozicioni Menaxhimi i Katastrofave Natyrore, kodi ekonomik 18468 në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.**

**5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**6. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shtyrjen e afatit të pagesë të këstit për lejet ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë;

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se nëse nuk do të ketë një dëmtim financiar, propozoi që të kemi një shtyrje të kësteve gjashtë mujore të kësteve, pasi që industria ndërtimore është e goditur mjaft shumë nga pandemia dhe kjo do ti ndihmonte bizneset tona në këtë kohë krize.

**Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së**-tha se kërkesa e bizneseve ka qenë që shtyrja e këtyre kësteve të jetë për 3 muaj, dhe konsideron se është mendim i përgjithshëm që kjo shtyrje të jetë për këtë afat i cili do ti ndihmonte bizneset tona të afarojnë më lehtë.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim lejohet shtyrja e afatit të pagesës së këstit për leje ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë.**

**2. Afati për shtyrjen e pagesës së këstit bëhet për tre (3) muaj nga dita e arritjes së obligimit për pagesë.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.**

**4. Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimi të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

7. Rishqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtri;

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-kërkoi që pjesë e vendimit të jetë edhe një pikë, ku thuhet se me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi paraprak lidhur me çështjen e caktimit të lokacionit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A në Vushtri.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së**-tha se në vendimi duhet të futet një pikë që më hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi paraprak lidhur me këtë çështje, ndërsa në bazën ligjore duhet të futet referenca në Ligjin për Planifikim Hapësinorë.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë Vendim caktohet lokacioni i Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” Sh.A, në objektin e ish TMK-së në Vushtri, që gjendet në pjesën e parcelës kadastrale P- 2358-12, në sipërfaqe prej 1550m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 41655m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale**

Vushtrri, pronë e Komuna e Vushtrrisë, e cila parcelë është brenda zonës Urbane të Komunës së Vushtrrisë e paraparë si zonë ndërtimore.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr. 235/20 i datës 26.11.2020.

5. Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimi të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Të ndryshme;

#### **Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:**

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-ngritit shqetësimin e banorëve të fshatit Stanoc i Epërm, për ndërtimin e një fabrike të tekstilit, në objektin shkollor, ai kërkoi sqarime nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit. Pastaj tek rruga magjistrale, është krijuar një rrezik i madh pas janë hequr pengesat nga rruga dhe aty automjetet lëvizin me një shpejtësi mjaft të madhe ku gjasat për rrezikim të qytetarëve janë potenciale dhe po ashtu ka pasur protesta ditëve të fundit nga qytetaret. Kjo çështje bie në kompetencë të ministrisë, por është mirë të angazhohemi të gjithë për ta gjetur një zgjidhje. **Faton Shabani, anëtar i kuvendit**-adreso shqetësimin e disa bizneseve të cilave nuk iu kanë dal subvencionet që komuna i ka akorduar në bazë të pakos ekonomike për rimëkëmbje nga pandemia covid-19.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-vlerësoi se prej se ka ardhur në pushtet LDK-ja në koalicion me LVV-në, në fshatin e tij dhe në rrethinë nuk është vendosur as edhe një gozhdë, e vërteta është se në kohën e PDK-së është punuar janë përfunduar shumë projekte si në rrugë ashtu edhe në infrastrukturë në përgjithësi. Ai përsëriti kërkesën e tij të kamotshme, lidhur me fushën në fshatin Pasomë e cila thënë shkurt është shkretuar, nga hedhja e pakontrolluar e mbeturinave, që kanë arritur deri në rrugë dhe po e pengon edhe qarkullimin e lirë të njerëzve dhe automjeteve. Lidhur me këtë problematikë, askush nuk është marr, dhe apeloj tek inspektorati që ta ketë në konsideratë dhe të del në teren për ta parandaluar këtë dukuri të shëmtuar.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-pyeti se çfarë ka ndodhur me projektin ndërtimi i depos së patates, ai janë zhvilluar procedurat dhe ka ndarë komuna mjetet për financimin e këtij projekti, derisa nuk kemi caktim të lokacionit. Pastaj kërkoj përgjigje me shkrim nga Drejtoria e Kulturës, lidhur me menaxhimin e stadiumit të qytetit se kush është duke e menaxhuar këtë stadium, d.m.th a është duke u menaxhuar nga komuna apo ndonjë OJQ, e cila pretendon se ka privatizuar klubin. **Afrim Namani, drejtor i DA-së**-tha se vërtet po tentohet të luhet politikisht shumë ulët. Pastaj shprehu keqardhje për fjalorin që përdori, por e vërteta është kështu. Tutje sqaroi se ka një kërkesë nga një kompani e tekstilit për ta gjetur një lokacion diku, por asnjë hap nuk është bërë në këtë drejtim. Kjo kompani e ka vizituar shkollën në fshatin Sllatinë, e ka vizituar objektin e shkollës së vjetër në Maxhunaj, dej ka vizituar objektin e shkollës së vjetër në Stanoc të Epërm i cili është i lirë totalisht pasi që nxënësit janë vendosur në objekti e ri shkollor. Gjatë ditës së djeshme banoret

lokal kanë thirrur drejtoreshën e shkollës, dhe kanë pyetur se çfarë po ndodhe me atë projekt gjë e cila është normale. Por është jo normale dhe jo etike që nga pozita e anëtarit të kuvendit të tentohet të krijohen kësi lloj insinuata dhe gjendje fiktive për amullë dhe përfitim politik, që po bëhet nga anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje në fshatin Stanoc i Epërm.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-vlerësoi se askush nuk ka tendenca politike dhe qëllime tjera të ulëta, por e vërteta është se kërkoi përgjigje nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit, lidhur me atë projekt që si anëtar i kuvendit të jetë i informuar, sepse askush nuk e kundërshtoj këtë projekt apriori, por shqetësimi dhe paranoja e drejtori z.Naman është irracionale dhe e pakuptueshme, ndoshta kjo i ndodh nga rezultati negativ në zgjedhjet e fundit.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së**-tha se nuk dëshiron të polemizoj me anëtarët e kuvendit, e aq më pak me një anëtar të kuvendit i cili votat i ka fituar nën flamurin e një partie politike tjetër, e i mbron ngjyrat e flamurit të një partie tjetër.

**Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit**-vlerësoi se nëse ndërrohet partia politike është parimore sepse zhvillohesh, dhe bënë diçka për qytetarin, ndërsa të qëndrosh në një parti politike e mos të bësh asgjë është vërtet e dëmshme.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se nuk ka pyetje palidhje por mund të ketë përgjigje palidhje, sepse vërtet është shqetësuese nëse ka tendencë që të merret objekti i një shkolle nga dikush dhe për këtë mos të jetë i informuar kuvendit dhe deri sa nuk kemi një vendim nga ana e tij. Kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit të jetë më i përmbajtur dhe matur në adresimit e tij ndaj anëtarëve të kuvendit pasi këtë të fundit përfaqësojnë qytetarin dhe adresojnë problemet e tyre.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së**-tha se nëse dikush është ndjerë i ofenduar atëherë ai kërkon ndjesë, dhe përsërit se ka një operator ekonomik i cili është i interesuar për të gjetur një lokacion për ndërtimin e një fabrike, por që nuk e di se kënd bëhet fjalë për cilën kompani.

**Mehdi Bejtullahu, anëtar i kuvendit**-pyeti drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, lidhur me ndërtimin e urës në fshatin Smrekonicë, se kur do të rifillojnë punime dhe kur pritet të përfundohet.

**Mbledhja përfundoi në ora 14:40.**

**Bastri Duraku**

  
Procesmbajtës

**Nasuf Aliu**

  
Kryesues i Kuvendit

